



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 46, Datë 12/05/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 27, datë 22.04.2020, e Shoqatës Treja, ku pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të komunitetit rom, nga z. E.R., Kryeministër i Shqipërisë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se në datën 14.04.2020, në rrjetet sociale janë publikuar video të komunitetit rom dhe egjiptian të qytetit të Fierit, të cilët ishin grumbulluar dhe ankoheshim për mungesën e ndihmave ushqimore dhe shpërndarjen e padrejtë të tyre nga ana e Bashkisë Fier. Disa video të tilla janë publikuar në rrjetin e tij social Facebook, nga Kryetari i Partisë Demokratike, dega Fier. Një gjë e tillë ka nxitur reagimin e Kryeministrit E.R., i cili në një publikim në rrjetin social Twitter, e ka etiketuar komunitetin rom të këtij qyteti “*të përdorur si mish për top për inskenime*”.

Shoqata Treja, e cila është një shoqatë, e cila mbron interesat e komunitetit rom, pretendon se përdorimi i një shprehje të tillë nga Kryeministri i Shqipërisë, është tepër diskriminues ndaj këtij komuniteti në qytetin e Fierit, i cili ishte i shqetësuar nga mungesat dhe nevojat në ushqime.

Shoqata ankuese thekson faktin se Qeveria Shqiptare ka hartuar, miratuar dhe po zbaton Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, duke pranuar kështu vulnerabilitetin e këtyre komuniteteve, si dhe ka marrë inisiativë për përmirësimin e situatës aktuale të këtyre komuniteteve. Por, një gjë e tillë nuk po ndodh, pasi një pjesë e romëve dhe egjiptianëve, që punonin në sektorin informal të ekonomisë janë diskriminuar nga qeveria, pasi

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

nuk u përfshinë dhe u lanë jashtë listës së subjekteve përfituese të “pagës së luftës” gjatë situatës së Pandemisë së Covid – 19. Nga ana tjetër, ky komunitet etiketohet nga Kryeministri si “*të përdorur për inskenime*”, ndërkohë që anëtarët e këtij komuniteti kanë nevojë për ushqim për të mbijetuar.

Shoqata Treja vë në dukje faktin se shprehja e përdorur nga Kryeministri është e paparanueshme, pasi ajo përforcon stereotipet diskriminuese ndaj komunitetit rom, si njerëz inferiorë. Faqja e Twitterit të Kryeministrit ndiqet nga 350 mijë njerëz dhe disa media raportuan mbi ngjarjen duke zgjedhur të kishin në titull pikërisht shprehjen “*mish për top*”, duke e përforcuar kështu impaktin e diskriminimit të romëve në opinionin publik. Kjo shoqatë pretendon se Kryeministri ka nënvleftësuar aftësinë vetëorganizuese të komunitetit rom, si dhe aftësinë e këtij komuniteti për të kërkuar të drejtat e tij. Shoqata Treja sugjeron dhe kërkon që në vend të përdorimit të shprehjeve të tilla, të kishte ndihmë konkrete ndaj komunitetit rom, sidomos në këtë periudhë krize të shkaktuar nga pandemia.

Në këto kushte, Shoqata Treja pretendon diskriminim për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Kryeministrit të Shqipërisë, si dhe kërkon falje publike nga z. E.R., për shprehjen e përdorur për këtë komunitet në rrjetin social Twitter.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 27, datë 22.04.2020, së Shoqatës Treja, KMD konstatoi se:

Në ankesën nr. 27, datë 22.04.2020, e Shoqatës Treja, pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të komunitetit rom, nga z. E.R., Kryeministër i Shqipërisë.

Deklarata e plotë e përdorur nga z. E.R., e shoqëruar edhe me video, ku paraqiten shumë qytetarë të grumbulluar në pritje të marrjes së ndihmave, është si vijon: “*E turpshme nxitja e komunitetit rom për të inskenuar shfaqje të rrezikshme për jetën nga ish-deputetë të caktuar, që paturpësisht gënjejnë publikun, duke përdorur romët si mish për top për të thënë se ja kështu u shpërndakan ndihmat në Fier e gjetkë #Çnjerëzore*”.

Nga analizimi i ankesës dhe pretendimeve të shoqatës Treja, Komisioneri gjykon se shprehja e përdorur nga Kryeministri E.R. “*të përdorur si mish për top për inskenime*” për komunitetin rom të qytetit të Fierit, nuk krijon *prima facie* përshtypjen e përdorimit të gjuhës urrejtjes, ndaj këtij komuniteti. Komisioneri gjykon gjithashtu se publikimi i bërë në rrjetin social Twitter, nuk konsiston në përbuzjen dhe diskriminimin e komunitetit rom nga z.E.R, por konsiston më shumë në shprehjen e shqetësimit për grumbullimin e njerëzve, në një kohë kur janë ndërmarrë shumë akte ligjore e nënligjore kufizuese e veprime informuese ndaj qytetarëve, në lidhje me rrezikun e Pandemisë të krijuar nga Covid-19, si dhe në shqetësimin për dezinformimin e publikut, në lidhje me shpërndarjen e paketës së ndihmave.

Komisioneri çmon se ankesa në tërësi konsiderohet e pabazuar dhe përfundimet e arritura nga shoqata Treja janë të pambështetura, por supozime, mbi të cilat nuk mund të mbështetet fillimi i shqyrtimit administrativ të saj.

Në nenin 33, pika 4, gërma (ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet shprehimisht: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;

Nga analizimi i provave shkresore të depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri gjykon se çështja objekt ankese nuk pajtohet me dispozitat e ligjit të sipërpërmendur dhe si e tillë nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 7, 20, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 27, datë 22.04.2020, së Shoqatës Treja, pasi ankesa është haptazi e pabazuar me ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dajeni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONER